



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5770/1 Prot.

Tiranë, më 16.8. 2023

URDHËR

Nr. 467, Datë 16.8.2023

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NGA
MASTER PROFESIONAL NË “MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR, KLASA I-V”, NË
MASTER PROFESIONAL NË “MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR”, NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë nga “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor, Klasa I-V”, me 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik (2 semestra), në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Mësuesi për Arsimin Fillor”, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, fillon në vitin akademik 2023-2024.
3. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI

